



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dëftuar / Prilazhen / Prilazhen / Received / Dëftuar /	14. 09 2023	VIII / god / year	
Organ / Njësia / Organ / Jedinica / Org / Unit	Nr. Prot / Pr. Prot / Prot No	Shtojca / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
Shp.MSHU	6085/2023		



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1002/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi -Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1002/2023 të datës 18.07.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted] të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat [redacted] me adresë: [redacted] kundër Vendimit me numër KD.nr.06/2023 i datës 21.06.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "Ndërprerje e marrëdhënies së punës" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 08.09.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.1002/2023 e datës 18.07.2023 e parashtruar nga ankuesi [redacted]
- II. Ndryshohet Vendimi KD.06/2023 i datës 21.06.2023 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, lidhur me shqiptimin e masës disiplinore ndaj ankuesit ashtu që masa disiplinore "Largim nga shërbimi civil" ndryshohet në masën disiplinore "Ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë për dy vjet".
- III. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, ashtu që ankuesin ta kthejë në vendin e tij të punës sipas aktit të emërimit të datës 12.07.2022.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesi [REDACTED], i cili sipas shkresave të lëndës është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar me datë 18.07.2023 dhe regjistruar me numër prot:5263/2023, kundër Vendimit me numër KD.nr.06/2022 i datës 21.06.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të masës disiplinore dhe zhvillimit të procedurës disiplinore ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e aplikuara ligjore të Ligjit Nrr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka bërë shkelje procedurale të përcaktuara me Rregulloren Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë për shkak se ankuesit nuk i është dhënë mundësia të deklarohet në seancë me rastin e rishqyrtimit të rastit, ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike ngase përgjegjësia e mbarëvajtjes dhe sigurisë në Qendrën e Paraburgimit nuk bie në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi Zv. Drejtorin e Qendrës së Paraburgimit, përjashtimisht në rastet kur Drejtori i Qendrës së Paraburgimit mungon, kurse në ditët respektive ky i fundit ka qenë në punë prandaj ankuesi nuk mund të mbahet përgjegjës dhe po ashtu Komisioni Disiplinor nuk ka marr për bazë deklaratimet dhe provat e ngritura nga ankuesi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 19.07.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Shërbimi Korrektues i Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë 20.07.2023 ka pranuar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës përgjigjen në kërkesë, së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Bazuar në kërkesën e Kryetarit të Kolegjit të datës 24.08.2022 për vazhdimin e afatit vendimmarrës të ankesës së ankuesit, Kryetari i Këshillit me datën 24.08.2023 ka nxjerrë Vendimin me numër VK/2023 me numër protokoli: 5808/2023 përmes të cilit ankesës A.nr.1002/2023 të datës 18.07.2023 ia ka vazhduar afatin e vendimmarrjes lidhur me këtë çështje ankimore edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.prot:5263/2023 të datës 18.07.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 30.03.2023; Vendimin për Themelimin e Komisionit Hetimor i datës 25.10.2023 nxjerrë nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK; Vendimin e datës 13.12.2022 me shifër KD/054 të Komisionit Disiplinor; Vendimin e datës 23.01.2023 me shifër KD/054 të Komisionit Disiplinor; Vendimin e datës 08.02.2023 me shifër KD/051 të Komisionit Disiplinor; Vendimin e Këshillit A.nr.615/2023 i datës 02.06.2023; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë i datës 20.01.2022; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë i datës 19.01.2023; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë i datës 13.12.2019; E-mailin e datës 11.07.2023 dërguar nga ankuesi për të autorizuarin e tij; E-mailin e datës 05.07.2023 dërguar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të SHKK për ankuesin; E-mailin e datës 04.07.2023 dërguar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të SHKK për ankuesin;

Vendimin e Këshillit A.nr.615.2023 të datës 02.06.2023; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 19.07.2023; Përgjigja në kërkesë e datës 20.07.2023; Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 21.06.2023; Procesverbalin e seancës së datës 21.06.2023; Ftesën për intervistë e datës 14.06.2023; Procesverbalin e seancës së datës 20.06.2023; Vendimin me numër VK/2023 me numër protokollit: 5808/2023 të Kryetarit të Këshillit; Ankesën me Nr.prot:2766/2023 të datës 17.03.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Fletë kthesën me shifër evidence:KD.nr.05/22; Vendimi me numër KD.nr.051/2022 i datës 08.02.2023 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Vendimi me numër KD.nr.051/2022 i datës 08.02.2023 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës për shqiptimin e masës disiplinore; Raportin përfundimtar i hetimeve i datës 09.12.2023 me numër:1303; Ftesën për intervistë të datës 01.12.2022; Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore të datës 23.11.2023; Deklaratën e bërë nga Sh.S me datë 23.11.2022; Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore 23.11.2022; Ankesën e zyrtarit [redacted] Kopje e mesazheve telefonike prej shtatë (7) faqesh; Akt emërimit e ankuesit të datës 12.07.2022 me shifër AE.nr.065/2022; Zarfën postar me shifër: R2777441; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 30.03.2023; Përgjigjen në kërkesë të datës 18.04.2023; Shkresën e Njesisë së Burimeve Njerëzore të datës 14.04.2023; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën " Zëvendës Drejtor në QP Gjilan"; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë i datës 19.01.2020; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë i datës 20.01.2022; Vendimi me numër KD.nr.051/2022 i datës 20.12.2022 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; E-mailin e datës 05.07.2022 dërguar nga [redacted] për ankuesin; E-mailin e datës 24.01.2022 dërguar nga [redacted] për [redacted]; Vendimin për themelimin e komisionit për vetë monitorim i datës 12.01.22; E-mailin e datës 08.11.2019 dërguar nga Sh.S për ankuesin; Raportin me shifër evidence Forma.1.1.2; E-mailin e datës 15.11.2019 dërguar nga A.M për ankuesin; E-mailin e datës 28.10.2022 dërguar nga ankuesi për Sh.S; Procesverbalin e seancës së datës 08.12.2022; E-mailin e datës 15.11.2021 dërguar nga [redacted] për ankuesin; Raportin e datës 10.11.2021 me raportin e bashkangjitur të datës 09.11.2021; Deklaratën zyrtarit [redacted]; E-mailin e datës 01.12.2022 dërguar nga [redacted] për ankuesin; E-mailin e datës 12.04.2023 dërguar nga [redacted] për [redacted]; E-mailin e datës 14.02.2023 dërguar nga [redacted] për ankuesin; Ankesën me Nr.prot:3306/2023 të datës 05.04.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 30.03.2023; Vendimi i datës 25.10.2022; Procesverbalin e seancës së datës 28.02.2023; Fletë kthesën e datës 10.03.2023; Vendimi me numër KD.nr.06/2023 i datës 10.03.2023 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Përshkrimi detyrave të punës për pozitën Zëvendës Drejtor i QP Prizren; Vendimi me numër KD/054/13/12/2022 i datës 13.12.2022 i Komisionit Disiplinor; Vendimi me numër KD.nr.054/2022 i datës 23.01.2023 i Komisionit Disiplinor; Vendimin e datës 26.01.2023 nr.:120 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Shërbimit të Përgjithshëm Korrektues të Kosovës; Fletë kthesën me shifër KD.nr.06/23; Vendimin e datës 13.03.2023 të kryesuesit të Komisionit Disiplinor; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 14.04.2023; Përgjigjen në kërkesë e datës 25.04.2023; Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore të datës 14.02.2023; Përgjigjen e ankuesit të datës 08.02.2023 lidhur me raportin hetimor të QPGJ; Njoftimin e ankuesit i datës 20.10.2022; E-mailin e datës 20.10.2022 dërguar nga ankuesi për [redacted] me korrespondencën e bashkangjitur prej tre faqesh ; E-mailin e datës 20.10.2022 dërguar nga [redacted] për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur prej dy faqesh; Ftesën për intervistë të datës 23.02.2023; Procesverbalin e seancës së datës 28.02.2023; Fletë kthesën e datës 15.03.2023; Fletë kthesën e datës 10.03.2023; Vendimin e datës 23.08.2021 të Drejtorit të QP Gjilan; Procesverbali i intervistimit i datës 08.11.2022 për zyrtarin [redacted]; Procesverbali i intervistimit i datës 08.11.2022 për zyrtarin [redacted];

datës 08.11.2022 për zyrtarin [redacted]; Procesverbali i intervistimit i datës 08.11.2022 për zyrtarin [redacted]; Procesverbali i intervistimit i datës 08.11.2022 për zyrtarin [redacted], Procesverbali i intervistimit i datës 08.11.2022 për zyrtarin [redacted] Lista e regjistrimet të sjelljeve të burgosurit [redacted] Dosja e të burgosurit [redacted] e datës 24.09.2022 me shkresat e bashkangjitura; Lista e regjistrimet të sjelljeve të burgosurit [redacted] për datat 02.11.2022-03.11.2023 dhe 05.11.2022; Lista e regjistrimet të sjelljeve të burgosurit [redacted] për datat 19.10.2022; Dosja e të burgosurit B.Rr e datës 17.08.2022 me shkresat e bashkangjitura; Dosja e të burgosurit [redacted] e datës 07.08.2022 me shkresat e bashkangjitura; Dosja e të burgosurit [redacted] e datës 20.07.2022 me shkresat e bashkangjitura; Dosja e të burgosurit [redacted] e datës 21.09.2022 me shkresat e bashkangjitura; Shkresën e datës 12.10.2022 lëshuar nga Departamenti Shëndetësor i Burgjeve; Lista e regjistrimi të vëzhgimit për të burgosurin [redacted] e datës 26.10.2022, 03.11.2022; 04.11.2022 dhe datës 07.11.2022; Dosja e të burgosurit [redacted] e datës 29.09.2022 me shkresat e bashkangjitura; Shkresën e datës 29.09.2022 lëshuar nga Departamenti Shëndetësor i Burgjeve; Lista e regjistrimi të vëzhgimit për të burgosurin [redacted] të datës 03.11.2022, 25.10.2022, 07.11.2022, Dosja e të burgosurit [redacted] e datës 18.10.2022 me shkresat e bashkangjitura; Shkresën e datës 18.10.2022 lëshuar nga Departamenti Shëndetësor i Burgjeve; Lista e regjistrimi të vëzhgimit për të burgosurin [redacted] e datës 21.10.2022, 23.11.2023, Vendimin e datës 20.10.2022 lëshuar nga Mbikëqyrësi i Lart [redacted]; Shkresën e datës 10.10.2022; Vendimin e datës 20.10.2022 lëshuar nga Mbikëqyrësi i Lart [redacted] për [redacted] me raportin e bashkangjitur të datës 20.10.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa A.nr.1002/2023 e datës 18.07.2023 e parashtruar nga ankuesi [redacted] është *pjesërisht e bazuar*, sepse:

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi [redacted] sipas Aktit të Emërimit AE.Nr.065/2022 të datës 12.07.2022 ka të themeluar marrëdhënien e punës pranë Shërbimit Korrektues të Kosovës në pozitën "Zëvendës Drejtor i Qendrës së Paraburgimit-Qendra e Paraburgimit Gjilan", ndërsa me datë 14.02.2023 Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, ka kërkuar nga Komisioni Disiplinor inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit për shkak të dyshimit se i njëjti ka kryer shkelje të rënda disiplinore të përcaktuara me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ndërsa kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore i njëjti e ka mbështet në Raportin Përfundimtar të Hetimeve me numër:1303 të datës 09.12.2022 i hartuar nga Komisioni Hetimor, sikurse përcaktohet tek pjesa e rekomandimit në pikën dhjetë (10), *citohet*: "Komisioni hetimor rekomandon Zëvendësuesin e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, të marr masa disiplinore ndaj vartësve të tij..., Zv. Drejtorit të Q.P Gjilan në bazë të nenit 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.", kurse Komisioni Disiplinor me datë 10.03.2023 kishte nxjerrë Vendimin me numër KD.nr.06/2023 përmes të cilit ankuesit i kishte shqiptuar masën disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil" ngase të njëjtin e kishte gjetur përgjegjës për shkelje të rënda.

Tutje, ankuesi kundër masës së shqiptuar disiplinore kishte parashtruar ankesë në Këshill me datë 05.04.2023, ndërsa Këshilli me datë 02.06.2023 ka nxjerrë Vendimin A.nr.615/2023 me numër protokolli:4580/2023 përmes të cilit e kishte shfuqizuar Vendimin me numër KD.nr.06/2023 të datës 10.03.2023 të Komisionit Disiplinor, ndërsa lëndën e kishte kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje për shkak të konstatimit të shkeljeve procedurale gjatë zbatimit të dispozitave të Ligjit Nr.06/114- për Zyrtarët Publik dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nga ana e Komisionit Disiplinor, me sugjerimin se Komisioni Disiplinor me rastin

e rishqyrtimit të lëndës së ankuesit duhet të marrë parasysh pikëpamjet juridike të specifikuara në Vendimin e Këshillit A.nr.615/2023 të datës 02.06.2023 sikurse që kanë qenë të obliguar ta marrin parasysh sugjerimet si në vijim: shkresën e ankuesit të datës 20.10.2022 përcjellë Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së dhe Udhëheqësit të tij të drejtpërdrejtë, thirrjen në seancë të iniciuesit të procedurës disiplinore, konstatimit dhe vlerësimit të saktë të të gjeturave në Raportin e datës 09.12.2022 të Komisionit Hetimor.

Komisioni Disiplinor pas rishqyrtimit të lëndës së ankuesit, me datë 21.06.2023 ka nxjerrë Vendimin me shifër KD.nr.06/2023 përmes të cilit ankuesin e ka gjetur përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore të përcaktuara me nenin 46 paragrafi 3 në paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: "Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës", ndërlidhur me elementet e përgjegjësisë disiplinore të pacaktuara si në nenin 45 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 i të njëjti ligj sikurse në vijim: "Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit", për shkak se Komisionin Disiplinor kë vlerësuar se ankuesi nuk i ka përmbushur detyrat e tij të punës të gjetura këto në raportin e Komisionit Hetimor të datës 09.12.2022.

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit si dhe analizimit nëse Komisioni Disiplinor me rastin e shqyrtimit të lëndës së ankuesit ka konstatuar saktë gjendjen faktike sipas vërejtjeve të dhëna nga ana e Këshillit përmes vendimit paraprak A.nr.615/2023, ka analizuar të gjeturat e raportit të Komisionit Hetimor të datës 09.12.2023 sikurse në vijim: "i burgosuri [redacted] sipas formularit përcjellës kishte qenë në vëzhgim çdo 10 minuta nga data 24.09.2022, (me datë 19.10.2022 nga zyrtari korrektues [redacted], nuk është përcjellur fare nga ora 07:30 min e gjer në ora 13:50); i burgosuri [redacted] sipas formularit përcjellës kishte qenë në vëzhgim çdo 10 minuta nga data 17.08.2022, (me datë 19.10.2022 nga zyrtari korrektues [redacted] nuk është përcjellur fare nga ora 14:00 e gjer në ora 14:50 minuta); i burgosuri [redacted] sipas formularit përcjellës kishte qenë në vëzhgim çdo 10 minuta nga data 07.08.2022, ndërsa nga data 12.10.2022 i ndërrohet vëzhgimi në çdo 2 ore me rekomandimin mjekësor (porse nga Drejtori apo Zv. Drejtori nuk është i aprovuar); i burgosuri [redacted] sipas formularit përcjellës kishte qenë në vëzhgim çdo 30 minuta, nga data 20.07.2022, ndërsa nga data 12.10.2022 i ndërrohet vëzhgimi në çdo i ore me rekomandimin mjekësor (porse nga Drejtori apo Zv. Drejtori nuk është i aprovuar), i burgosuri [redacted] sipas formularit përcjellës kishte qenë në vëzhgim permanent nga data 21.09.2022, ndërsa nga data 12.10.2022 i ndërrohet vëzhgimi në çdo 30 minuta me rekomandimin mjekësor (porse nga Drejtori apo Zv. Drejtori nuk është i aprovuar), i burgosuri [redacted] sipas formularit përcjellës kishte qenë në vëzhgim permanent nga data 29.09.2022 ndërsa nga data 12.10.2022 i ndërrohet vëzhgimi në çdo 30 minuta me rekomandimin mjekësor (porse nga Drejtori apo Zv. Drejtori nuk është i aprovuar) dhe po ashtu në të njëjtën raport konstatohet fakti se Komisioni Hetimor kishte konstatuar se tek këto raste përgjegjësia ka qenë e shpërndarë varësisht nga pozita dhe përgjegjësitë që kanë pasur zyrtarët e shërbimit korrektues në rastin konkret edhe ankuesi, madje për të njëjtin Komisioni Hetimor sipas raportit në fjalë kishte sugjeruar Zëvendësuesin e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues që për ankuesin të veprohet sipas dispozitave të nenit 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik e që sipas së cilës dispozitë përcaktohet se: "Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë", ndërlidhur me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: "Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje" dhe ka ardhur në përfundimin se sipas raportit në fjalë të Komisionit Hetimor duke e shpërndarë përgjegjësinë



edhe tek zyrtarët në fjalë, ka udhëzuar menaxhmentin e lartë që ankuesit t'i shqiptojë masën disiplinore "vërejte", nga rrjedh se në rrethanat e rastit konkret Komisioni Disiplinor me rastin e rishqyrtimit të lëndës së ankuesit nuk ka arritur të konstatojë saktë gjendjen faktike pavarësisht deklarimit se të njëjtit ia kanë falur besimin të gjeturave të Raportit Hetimor të datës 09.12.2023, raport i cili nuk e ngarkonte ankuesin për shkelje të rënda disiplinore në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka gjetur se Komisioni Disiplinor me rastin e rishqyrtimit të lëndës së ankuesit nuk ka arritur të konstatojë saktë gjendjen faktike, madje nuk ka vepruar sipas sugjerimeve të vendimit të Këshillit A.nr.615/2023 të datës 02.06.2023 kur ishte udhëzuar që të trajtojë pretendimin e ankuesit lidhur me shkresën e tij dërguar Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së dhe Udhëheqësit të tij të drejtpërdrejtë datës 20.10.2022, e që sipas së cilës shkresë rezulton se ankuesi kishte paralajmëruar menaxhmentin e lartë për lëshimet e bëra në institucionin/Qendrën e Paraburgimit në Gjilan lidhur me vëzhgimin dhe trajtimin e të burgosurve sikurse u specifikua si më lartë edhe në të gjeturat e raportit hetimor të datës 09.12.2022, nga rrjedh se zyrtarët të cilit ishin raportuar për përgjegjësi nga ankuesi sipas së njëjtës shkresë, po ashtu zyrtar të njëjtë ishin nxjerrë përgjegjës edhe sipas Raportit të datës 09.12.2022 të hartuar nga Komisioni Hetimor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, nga rrjedh se në rrethanat e rastit konkret Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit është dashur të kenë parasysh zbatimin e drejtë të parimit të individualizimit të masave disiplinore sikurse përcaktohet me nenin 50 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik: "1. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit.", ngase shkresa e datës 20.10.2022 ishte në frymën e këtij veprimi.

Mirëpo, Kolegji i Këshillit nga shkresat e administruara të lëndës ka gjetur se ankuesi mban përgjegjësi disiplinore, ngase në cilësi të pozitës së punës "Zëvendës Drejtor i Qendrës së Paraburgimit-Qendra e Paraburgimit Gjilan" dhe duke marrë për bazë edhe përshkrimin e detyrave të punës i njëjti nuk mund të zhvishet nga përgjegjësia pasi që edhe sipas legjislacionit të veçantë, respektivisht përshkrimit të detyrave të punës për pozitën që ushtron përcaktohet ndër të tjera se: "Detyra Kryesore: Siguron informimin dhe interpretimin e parimeve dhe procedurave operative dhe të sigurisë; Mbikëqyrë personelit drejtpërdrejtë apo përmes vartësve të tij; Kryen Inspektime ditore në të gjitha hapësirat e Qendrës së paraburgimit; Verifikon të gjitha standardet e burgut përfshirë sigurimin, duke i raportuar drejtorit...; Në bashkëpunim me drejtorin monitoron dhe vlerëson parimet (rregulloret) dhe procedurat si dhe praktikon një ambient të sigurt për personelin, të burgosurit dhe vizitorët; ... etj" andaj i njëjti është përgjegjës për shkeljet e evidentuara sikurse në raportin hetimor të datës 09.12.2022 lidhur me pjesën e përgjegjësive sipas gjetjeve të theksuar, të kundërtën e të cilave ankuesi nuk ka mundur t'i dëshmojë para Këshillit me prova bindëse, nga rrjedh se ankuesi ka konsumuar dy nga pesë elementet e përgjegjësive disiplinore të përcaktuara me nenin 45 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik sikurse janë ekzistimi i veprimit të paligjshëm apo mosveprimi dhe kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimin.

Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të kësaj lënde ka marrë për bazë edhe dy vendimet e tjera të Këshillit, respektivisht Vendimin e datës 18.11.2021 me shifër A.nr.282/2021 përmes të cilit ankuesit i ishte refuzuar ankesa ndërsa i ishte lënë në fuqi masa e shqiptuar disiplinore "vërejte" si dhe Vendimin e datës 12.04.2023 me shifër A.nr.426/2023 përmes të cilit ankuesit i ishte refuzuar ankesa ndërsa i ishte lënë në fuqi masa e shqiptuar disiplinore nga Komisioni Disiplinor "ndalim i 20% të pagës për periudhën 1 muaj" për shkelje të rënda disiplinore.

Prandaj, nga se u tha si më lartë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizimit të dispozitave të aplikuara ligjore të ligjit material dhe të gjeturave të raportit hetimor të datës 09.12.2022 ka ardhur në përfundimin që ankesa e ankuesit e datës 18.07.2023 është pjesërisht e bazuar, ashtu që masa disiplinore "*Largimin nga Shërbimi Civil*" nuk është në proporcion me shkeljen e konstatuar nga ankuesi, respektivisht Komisionin Disiplinor me rastin e shqyrtimit të lëndës së ankuesit nuk ka arritur të zbatojë drejtë përmbushjen në mënyrë kumulative të elementeve të përgjegjësive disiplinore të përcaktuara me nenin 45 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ngase nuk ka arritur të konstatojë ndodhjen e pasojës dhe dëmit si dhe të bëjë lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit, sikurse nuk ka marr përbazë parimin e individualizimit të masave disiplinore sikurse përcaktohet me nenin 50 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik kur ka ardhur në përfundimin se ankuesit duhet t'i shqiptohet masa me rëndë disiplinore në shërbimin civil.

Andaj, nga se u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankuesi është përgjegjës për shkelje disiplinore dhe duke marrë përbazë se i njëjti ka përsëritur shkeljet disiplinore, dhe duke vepruar në pajtim me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: "*Shkelje të rënda konsiderohen: kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi;*" Kolegji i Këshillit konstaton është përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore, mirëpo duke marr përbazë rrethanat e caktuara si më lartë, ka vendosur që të ndryshojë masën e shqiptuar disiplinore ashtu që masa e shqiptuar nga Komisionin Disiplinor përmes Vendimi KD.06/2023 e datës 21.06.2023, lidhur me shqiptimin e masës disiplinore ndaj ankuesit "*Largim nga shërbimi civil*" ndryshohet në masën disiplinore "*Ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë për dy vjet*", masë kjo e cila është përcaktuar me dispozitat e nenit 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ashtu që ankuesit i është dhënë mundësia e fundit ngase masa e ndryshuar është pararendëse e masës disiplinore Largimi nga Shërbimi Civil, ashtu që në rast të përsëritjes së shkeljeve disiplinore nga ana e ankuesit, i hapet rrugë shqiptimit të masës më të rëndë disiplinore, mirëpo gjithherë duke zbatuar drejtë dispozitat e ligjit material dhe ligjit të veçantë dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sikurse në aspekt të zbatimit të çështjeve procedurale apo shqyrtimeve material.

Nga se u tha si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit ka ardhur në përfundimin se ankesa e ankuesit e datës 18.07.2023 është pjesërisht e bazuar ashtu që Vendimi KD.06/2023 e datës 21.06.2023 i Komisionit Disiplinor është ndryshuar sikurse në dispozitivin e këtij vendimi, ndërsa institucionin punëdhënës, obligohet që ankuesin ta kthejë në vendin e tij të punës me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia a e punës sipas aktit të emërimit të datës 12.07.2022, dhe nëse aktet e goditura janë ekzekutuar nga institucionin punëdhënës, atëherë të njëjtit obligohen që ankuesit t'ia kompensojnë në mënyrë retroaktive edhe ndalesën e pagës në emër të ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në ditën e zbatimit të këtij vendimi.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafit 4 të Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1002/2023

Flakron GASHI

[Signature]
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

[Signature]
Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit, avokat [REDACTED]
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së